



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 2, dt. 15.03.2024

MBI MIRATIMIN E SHTIMIT NË BUXHET DHE PËRDORIMIT TË FONDIT TË ARDHUR NGA BE, NËPËRMJET BANKËS TË SHQIPËRISË, PËR RIMBURSIMIN E SHPENZIMEVE TË PROJEKTIT CLLD

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar Ligjit "Për buxhetin e vitit 2024". Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, si dhe udhëzimit nr.35 dt.31.09.2020 "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondave të financimeve të huaja në kuadrin e marëveshjeve ndërkombëtare", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

- Të miratojë përdorimin e fondit të ardhur për rimbursimin e shpenzimeve të kryera për projektin e huaj CLLD, prej 9044710.87 lekë,
- Të miratojë shtesë në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2024 të fondit të sipërcituar në vlerë 9044710.87 lekë.
- Fondi prej 9044710.87 lekë do të përdoret për projekte të tjera me financim të huaj që Këshilli i Qarkut mund të fitojë, për të mbuluar pjesën e bashkëfinancimit apo parafinancimit, si dhe për investime në sektorin e turizmit në bashkëpunim me bashkitë, sipas strukturave buxhetore të mëposhtme:

- | | |
|-----------------|---|
| 00/08220/01/602 | 4084710.87 lekë (Bashkëfinancime në projektë të BE-së) |
| 00/04130/01/231 | 4960000 lekë (Investime në sektorin e turizmit në bashkëpunim me bashkitë) |
| 4. | Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit. |
| 5. | Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. |

Konceptoi: O. Beqiraj
Juristi: Gj. Kristo
Sekretari: B. Muço

Erjon NEXHİPI
Kryetari i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI MIRATIMIN E SHTIMIT NË BUXHET DHE PËRDORIMIT TË FONDIT TË ARDHUR NGA BE, NËPËRMJET BANKËS TË SHQIPËRISË, PËR RIMBURSIMIN E SHPENZIMEVE TË PROJEKTIT CLLD

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise”, i ndryshuar Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, udhëzimit nr.35 dt.31.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marëveshjeve ndërkombëtare”, Vendimit të Keshillit te Qarkut nr. 25 date 22.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2024” si dhe bazuar në komunikimet shkresore me Ministrinë e Financave në lidhje fondet që na vijnë nga projektet me financim të huaj që ka zbatuar Këshilli i Qarkut, për rimbursimin e shpenzimeve të kryera , ju paraqesim për miratim shtimin në buxhet dhe përdorimin e fondit të ardhur nga BE-ja, nëpërmjet bankës të shqipërisë, për rimbursimin e shpenzimeve të kryera nga Këshilli I Qarkut, për projektin clld.

Këshilli i Qarkut Korçë ka zbatuar 5 projekte të finançuara me fondet e Bashkimit Europian. Si pjesë e zbatimit të tyre, institucioni ka planifikuar në buxhetin e saj gjatë gjithë kësaj periudhe, fonde për bashkëfinancimet dhe parafinacimet, sipas legjisacionit në fuqi. Duke qënë se donatori(BE) bën disbursimet pas verifikimit të shpenzimeve dhe aktiviteteve të kryera, lind nevoja e parafinancimit me vetë fondet e institucionit.

Konkretnisht projekti CLLD(Cultour) ka përfunduar, pra nuk ka më aktivitete për tu realizuar, ndërkohë që ashtu si edhe për projektet e tjera nuk ka përfunduar disbursimi i të gjitha fondeve nga donatori.

Disbursimi i fundit që është bërë nga donatori në llogarinë speciale të Bankës të Shqipërise për projektin CLLD, është 87043.7 euro, vlerë kjo e cila kaloi nga llogaria speciale e projektit CLLD në BSH, në llogarinë tonë në thesar duke u konvertuar në 9044710.87 lekë, për rimbursimin e shpenzime te kryera paraprakisht nga fondet tona buxhetore për këtë projekt.

Ky fond do ti bashkohet buxhetit të vitit 2024 sipas strukturave më poshtë:

00/08220/01/602 4084710.87 lekë (Bashkëfinancime në projektë të BE-së)
00/04130/01/231 4960000 lekë (Investime në sektorin e turizmit në
bashkëpunim me bashkitë)

Në kushtet që Këshilli i Qarkut është në fazën e aplikimit për të fituar projekte të reja që financohen nga Bashkimi Europian dhe që do i shërbejnë të gjithë rajonit dhe komunitetit në tërësi, është e nevojshme dhe rjë garanci financiare për projektet që mund të fitohen, si për pjesën e bashkëfinancimit, ashtu edhe për atë të parafinancimit.

Në këto kushte, i propozojmë Këshillit të miratojë fndin e mësipërm për tu përdorur për bashkëfinancime në projektet e BE-së në të cilat Qarkut do të jetë pjesë dhe që do i shërbejnë të gjithë Rajonit tonë, në ato sektorë që kanë më tepër nevojë për vëmendje dhe investim.

Gjithashtu shuma prej 4960000 do ti shtohet zërit “Investime në sektorin e turizmit në bashkëpunim me bashkitë”, sipas propozimeve që ka një ardhur nga Bashkitë e Qarkut për projekte të ndryshme investimesh në këtë sektor.

Korçë me 13.03.2024

Oljona Beqiraj
Përgjegjëse e Financës

